

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm** , Gjyqtarja **Ilirjana Hoti** , me sekretaren juridike Flutur Nagavci, në çështjen penale kundër të akuzuarit R.A. nga fsh. S. ,K-Gj. për shkak të veprës penale nga neni 324të KPRK-, sipas Aktakuzës të Prokurorisë Themelore –DP në Gjakovë, PP.nr.1173/17 të dt.30.10.2017, në shqyrtimin fillestar të mbajtur më datë **26.03.2018**, në prani të Prokurorit të shtetit A. Z. dhe të akuzuarit R.A. , të njëjtën ditë mori dhe shpalli këtë:

**A K T G J Y K I M**

I akuzuari **R. A.** , nga fshati S. K Gj. , i biri i M. dhe i F. e gjinisë N. , i lindur më datë ... në Gj. , shkollën mesme, i pa punë , i gjendjes së dobët ekonomike, i pa martuar ,shqiptar, shtetar i Republikës së Kosovës, me ID .....

**Ë s h t ë f a j t o r :****Sepse:**

-me datë të pavërtetuar e deri me dt. 10.03.2017,ne lokalin e tij ne Rr”...” K Gj... ,me qellim që vetit ti sjellë përfitim pasuror te kundërligjshëm me qellim fitimi në mënyrë te paautorizuar ka shfrytëzuar energjinë eklektike në kundërshtim nga neni 324 te KPK-ës ,nr. 04/L-082 te KPK-ës, konsumator i lartcekur nuk e dorëzon orëmatësin edhe pse personat zyrtar kanë qene te obliguar qe te lexojnë dhe ta dërgojnë ne Qendrën e Kalibrimit për Kontroll ,me këtë veprim bene vjedhje te njehsorit elektrik , i cili sipas Ligjit për Energji Elektrike është prone e KEDS-it, po ashtu shmang njehsorin elektrik në fjalë ,ku energjia elektrike e shpenzuar nuk është regjistruar ,me ç’rast te dëmtuarës KEDS- Divizioni i Rrjetit – Distrikti ne Gj. ka shkaktuar dem ne vlerë prej 929.07 euro.

**- me çka ka kryer veprë penale lejimi i njehsorëve te ndryshuar te shërbimeve nga neni 324 te KPRK-ës .**

Andaj Gjykata në mbështetje te nenit 4,17,41,45,46,73 te KPRK-ës dhe nenit 324 të KPRK-ës , te akuzuarit ia shqipton :

**DËNIMIN ME BURG**

**I.** Me dënim me burgim me kohëzgjatje **prej 2 (dy) muajve** si dhe dënimin me gjobë ne shume **prej 100(njëqind) euro**, të cilat dënime do te ekzekutohet në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

**Konform nenit 47 me kërkesën e të akuzuarit dhe pëlqimin e të akuzuarit, dënimi i shqiptuar me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) muajve, i zëvendësohet me:**

**DËNIM ME GJOBË**

**II.** Dënim me gjobë në shumën prej **300,00 (treqind).-€**, i cili dënim do të paguhet në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i akuzuari nuk e paguan dënimin me gjobë, i njëjti i zëvendësohet me dënimin e parapare me piken e I-rë te dispozitivit të Aktgjykimit .

**Gjykata bazuar ne nenin 80 te KPRK-ës ,i shqipton :  
DËNIMIN ME GJOBË**

Dënimin unik me gjobë ne shume prej **400 (katër qind ) euro** ,i cili dënim do te paguhet ne afatin prej 15 ditëve ,nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

E dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet ne kontest civil.

Detyrohet i akuzuari që të paguaj shpenzimet procedurale të përcaktuara nga ana e gjykatës dhe ne emër të paushallit gjyqësor shumën prej **20,00.-€**, në afat prej **15** ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

**A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Gjakovë, me aktakuzën PP.nr.1173/17 të dt. 30.10.2017, e ka akuzuar të akuzuarin R. A. nga fsh. S. K. Gj. , për shkak të veprës penale lejimi i njehsorëve te ndryshuar te shërbimeve nga neni 324 te KPRK-ës, duke propozuar që i akuzuari të shpallet fajtor dhe te dënohet sipas ligjit .

Gjatë shqyrtimit fillestar me dt.26.03.2018, përfaqësuesi i PTH-DP, në Gjakovë , Prokurori Armend Zenelaj , lexojë aktakuzën PP.nr. 1173/17 te dt. 30.10.2017 dhe deklaroi se mbetet në tërësi pranë aktakuzës.

I akuzuari R. A. , gjate shqyrtimit fillestar, deklaroi se e pranon ne tërësi fajësinë sipas aktakuzës me të cilën pandehet duke i ditur edhe me parë pasojat e pranimi te fajësisë ne mënyrë vullnetare dhe pa presion , me qene se njehsori ka qene i shkyçur nga KEDS-i e te cilën njehsor unë e kam hekur me qene se kam pasur frikë se i njëjti do te keqpërdoret me qe i njëjti njehsori nuk kishte ngarkesë dhe njëherë unë e kisha lëshuar atë lokal . Gjithashtu edhe përkundër faktit qe e pranojë ne tërësi veprën penale me te cilën ngarkohem me qene se njehsorin ne fjalë nuk e kam dorëzuar e kontestojë lartësinë e demit te llogaritur nga e dëmtuara me qe një gjendje e tillë është konstatuar pa u bere verifikimi i pajisjeve apo ndonjë ekspertize përkatëse me te cilën do te konstatohej lartësia e demit te shkaktuar te dëmtuarës , andaj i propozoi gjykatës qe duke marr parasysh rrethanat lehtësuese si pranimi i fajësisë, pendimi i shprehur ne gjykate për veprën e kryer duke mos ditur se jam duke bere shkelje ligjore ,premtimi se ne te ardhmen do te jem me i kujdesshëm , si dhe faktin se është hera e parë që kam rene ndesh me ligjin te me shqiptojë një dënim me te butë dhe nëse gjykata ka mundësi ligjore qe dënimin e shqiptuar me burg te me zëvendësojë me dënim me gjobë.

Duke u deklarua lidhur me pranimin e fajësisë prokurori i shtetit A.Z. deklaroi se se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë pasi qe i njëjti është i vetëdijshëm për pasojat dhe favorët juridike te pranimi te fajësisë, dhe se aktakuza ka mbështetje ne provat materiale qe gjenden ne shkresat e lendes, ndërsa sa i përket lartësisë së demit të kontestuar nga këtu i akuzuari me qe nuk kemi ndonjë ekspertizë me te cilën do te vërtetohet larësin e demit te shkaktuar te dëmtuarës e njëjta te udhëzohet në kontest civil, gjykatës i propozoi qe te njëjtin ta shpallet fajtor te dënohet sipas ligjit te obligohet ne pagesën e shpenzimeve procedurale.

Në shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike :

Ne tërësi u vërtetua se i akuzuari R.A. , me datë te pavërtetuar e deri me dt. 10.03.2017,ne lokalin e tij ne Rr”...” K Gj. ,me qellim qe vetit ti sjellë përfitim pasuror te kundërligjshëm me qellim fitimi në mënyrë te paautorizuar ka shfrytëzuar energjinë eklektike në kundërshtim nga neni 324 te KPK-ës ,nr. 04/L-082 te KPK-ës, konsumator i lartcekur nuk e dorëzon orëmatësin edhe pse personat zyrtar kanë qene te obliguar qe te lexojnë dhe ta dërgojnë ne Qendrën e Kalibrimit për Kontroll ,me këtë veprim bene

vjedhje te njehsorit elektrik , i cili sipas Ligjit për Energji Elektrike është prone e KEDS-it, po ashtu shmang njehsorin elektrik në fjalë ,ku energjia elektrike e shpenzuar nuk është regjistruar ,me ç'rast te dëmtuarës KEDS- Divizioni i Rrjetit –Distrikti ne G. i ka shkaktuar dem ne vlerë prej 929.07 euro.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimit i fajësisë nga i akuzuari i cili ne shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë ,për shkak te se cilës gjykata nuk ka administruar provat ,gjykata ka ardhur ne përfundim se pranimit i fajësisë nga i akuzuari është bere ne pajtim me nenin 248 te KPPK-ës. Gjate pranimit te fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatojë se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit te fajësisë ,pranimit është bere vullnetarisht nga i akuzuari, pranimit i fajësisë mbështetet ne faktet dhe provat qe i përmban aktakuza ,ne materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje te qarte ligjore ose gabime faktike .

Gjykata nga te cekurat me lartë ka ardhur ne përfundim se ne veprimet e te akuzuarit formohen te gjitha elementet e veprës penale te përshkruara si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur qe te akuzuarin ta shpalle fajtor dhe ta gjykojë ne bazë te ligjit ,me pare duke vërtetuar përgjegjësisë penale juridike te tij.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj te akuzuarit ,gjykata ka pasur parasysh të gjitha rrethanat nga neni 73 të KPK-së ,të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit .Rrethana rënduese nuk gjeti ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata ka marrë parasysh personalitetin e te akuzuarit , pranimitin e vullnetshëm të fajësisë nga i akuzuari, pendimin e tij , sjelljen korrekte të akuzuarit në gjykim , premtimi se një veprim i tillë nuk do të përsëritet, gjendja e dobët ekonomike , si dhe faktin se i njëjti me pare nuk ka qene i dënuar nga ana e gjykatës . Kështu që duke mos gjetur rrethana rënduese gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin me burgim në kohëzgjatja prej 2 (dy) muajve dhe dënimin me gjobë ne shume prej 100 (njëqind ) euro , me bindje se edhe me këto dënime do ta arrihet qëllimi i dënimit i parapare me dispozitat e nenit 41 te KPK-se.

Pas shpalljes së aktgjykimit, me kërkesën dhe pëlqimin e të akuzuarit, Gjykata ne kuptim te dispozitës te nenit 47 dënimin e shqiptuar me burgim e ka zëvendësuar me dënim me gjobe me pëlqimin e personit te dënuar si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi, me shpresë dhe bindje se me dënimin e shqiptuar, do te arrihet qëllimi i dënimit i parapare me Ligj dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari.

Vendimi për udhëzimin e palës se dëmtuar ne kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike është marr bazuar ne nenin 463/2 te KPP-ës.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushalli gjyqësor bazohet në dispozitat e nenit 450 par.1dhe 2 nën paragrafi 2.6 te KPP-së.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi .

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,  
P. nr.738/17 më datë 26.03.2018.**

**Sekretarja juridike,  
Flutur Nagavci**

**G j y q t a r j a,  
Iirjana Hoti**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij Aktgjykimi mund të paraqitet ankesë ,në afatin prej **15 ditësh**, nga dita e marrjes se tij ne dorëzim ,Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate.

